



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KOMISIONI I QIRADHËNIES SË TOKËS BUJQËSORE TË PANDARË

Nr. 5783/2 Prot

Maliq, më 19.01.2018

VENDIM

Nr. 1, DATË 19.01.2018

PËR

“SHQYRTIMIN DHE VLERESIMIN E OFERTAVE”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 510, date 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e te patrupëzuara” si dhe pika 5 dhe 11 e Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e perkohshem të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", nga ana e Komisionit të Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë, u konstatua si më poshtë:

Nga ana e Bashkisë Maliq, pas Vendimit të Këshilli Bashkiak Nr.181, datë 27.10.2017 “Për miratimin e fillimit të procedurave për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara, Nr.337, Nr.338, ZK 1900, Gurishtë, Njësia Administrative Përg, Bashkia Maliq”, dhe konfirmimit me shkresën nr. 891/4 prot, date 06.11.2017 nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, u procedua si mëposhtë:

K.Q.T.B.P ne vazhdim te punes se vet, me procesverbalin e datës 13.12.2017, caktoi dokumentat që duhet të paraqiten, pikët e vlerësimit për konkurruesit dhe cmimin minimal.

Bashkia Maliq, në zbatim të dispozitave ligjore sipas udhëzimit nr.1 , publikoi/afishoi shpalljen për dhënie me qira të tokave bujqësore te sipercituara, pranë Njesisë Administrative Përg, (fshatin Gurishtë, Pleqësisë së fshatit), pranë ambienteve të Bashkisë Maliq Qendër, si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë www.bashkiamaliq.gov.al.

Sipas njoftimit, u mbledh K.Q.T.B.P, ditën e Premte, me datë 19.01.2018, ora 10:00, ku

VEREN :

Se janë paraqitur 2 (Dy) zarfa, të dy zarfat janë të 1 (Një) subjekti, Nr.5783 Prot., date 04.12.2017 , ku nje zarf ka dokumentat origjinale dhe zarfi tjetër ka dokumentat kopje,

Mbas hapjes së zarfit rezulton se, Subjekti/person fizik Altin Çeçi, ka paraqitur :

- Të dhënat e kërkuesit/ Vërtetim për shlyerje të detyrimeve nga organet vendore;
- Afati i qirasë- 35 vjet;
- Veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira, duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari - vreshtari;
- Aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe përpunimin e produkteve;
- Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj;
- Burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare;
- Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
- Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit)-8 200 l/ha/vit;
- Vërtetimin e lëshuar nga DAMT-ja e Qarkut, ku të tregohet kategoria e resursit të tokës bujqësore, siç rezulton në dokumentacionin kadastral-VII;
- Plan i hollësishëm i biznesi.

KQTBP bazuar në kriteret dhe dokumentacionin e paraqitur, vuri re se dokumentacioni nuk ishte në përputhje me shpalljen publike për dhënien me qira të dy tokave bujqësore të cilat në total janë 2.12 ha, pasi plani i biznesit i paraqitur nga personi fizik, ishte për 18 ha, për të cilën nuk ka paraqitur dokumentacionin që e disponon. Gjithashtu u vu re se në dokumentacionin e paraqitur nga ZVRPP disa prona rezultojnë “shtet”, çka konsiston se pavarësisht këtij fakti, pronat të cilat rezultojnë shtet nga verifikimet e bëra nga Njësia Administrative Pirg, nga printimet e III-ta dhe formulari 06 i AMTP-ve janë të ndara në bazë të ligjit Nr.7501/1991 “Për Tokën”.

Nisur nga këto fakte dhe mbasi u hodh në votim, me 7 vota PRO dhe 0 KUNDER,

VENDOSI :

1. Të anullojë procedurën e dhënies me qira.
2. Të shpallë sërish procedurën e dhënies së tokave me qira, sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.
3. KQTBP pas nënshkrimit të këtij vendimi nga të gjithë anëtarët e saj, duhet të bëjë shpalljen e vendimit pranë Bashkisë Maliq, si dhe t’i njoftohet palës pjesëmarrëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall sot më datë 19.01.2018.

KOMISIONI :

ANËTARË:

Tefik Mecollari
Liri Maho
Edison Bregu
Petrit Yzo
Genci Floqi
Xhensila Adri

Nënshkrimi


Kryetar i KQTBP-së së Bashkisë Maliq

Vasillaq ÇINOKU

